

LIGJ
Nr.10 219, datë 4.2.2010

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9482, DATË 3.4.2006 “PËR LEGALIZIMIN,
URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë shkronja “dh” riformulohet si më poshtë:

“dh) për pjesën e sipërfaqes mbi 500 m², sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Çdo pronar i ndërtimit pa leje, që trajtohet sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të paragrafit të parë të këtij neni mund të paguajë me bono privatizimi deri në 70 për qind të vlerës së parcelës ndërtimore jashtë vijave të verdha”.

Neni 2

Në nenin 20, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Çdo pronar i ndërtimit pa leje, që trajtohet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të paragrafit të parë të këtij neni, mund të paguajë me bono privatizimi deri në 70 për qind të vlerës së parcelës ndërtimore të vendbanimeve/ndërtimeve informale brenda vijave të verdha”.

Neni 3

Në nenin 21 bëhet ky ndryshim:

Në paragrafin e parë shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) për pjesën e sipërfaqes mbi 100 m², sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë”.

Neni 4

Dispozita kalimtare

1. Personat, të cilët i kanë kryer pagesat për parcelat ndërtimore të ndërtimit pa leje përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë ligj.

2. Për të përfituar nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për pjesën e mbetur të detyrimit apo për rikthimin e shumave të paguara në lekë, në këmbim të dorëzimit të bonove të privatizimit, personat duhet të paraqesin kërkesë, me shkrim, pranë ALUIZNI-it brenda 3 muajve

nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat dhe afatet e rimbursimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6431, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**